## Formular për SYLLABUS të Lëndës

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| Njësia akademike: | **Gazetari** |
| Titulli i lëndës: | **Bazat e komunikimit masiv I** |
| Niveli: | **Bachelor** |
| Statusi lëndës: | **Obligative** |
| Viti i studimeve: | **II, semestri 3** |
| Numri i orëve në javë: | **2+2** |
| Vlera në kredi – ECTS: | **6** |
| Koha / lokacioni: | |
| Mësimëdhënësi i lëndës: | **Prof.Dr. Lindita Tahiri** |
| Detajet kontaktuese: | **lindita.tahiri@uni-pr.edu** |
| | |
| Përshkrimi i lëndës | Bazat e Komunikimit Masiv është përvetësimi i koncepteve kyçe të komunikimit dhe në veçanti të komunikimit masiv, shqyrtimi i natyrës, teorisë dhe efekteve të komunikimit masiv, dhe analiza vlerësuese e mënyrave të ndikimit të komunikimit masiv në formësimin e proceseve shoqërore, kulturore dhe politike. |
| Qëllimet e lëndës: | Nëse studenti i përmbush angazhimet e veta dhe kontribuon me diskutime në orë, me njohuritë dhe shkathtësitë e fituara nga kjo lëndë, do të |

| | |
|---|---|
| | arriheshin ndryshime pozitive në jetën e tij/saj - dhe, në shoqëri.<br>Qëllimet e kësaj lënde është që të nxisë të menduarit kritik tek studentët në mënyrë që ata të kuptojnë se si mediat masive ndikojnë në jetën dhe në pikëpamjet tona. Studentët do të analizojnë lloje të ndryshme të medias përfshirë imazhe, video, lojëra dhe internet.<br>. |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të kësaj lënde, studenti **do të duhej** të jetë në gjendje që:<br>1. T'i kuptojë dhe t'i përkufizojë konceptet themelore të komunikimit masiv.<br>2. T'i analizojë mesazhet e llojllojshme të komunikimit masiv dhe mënyrën se si paraqiten përmes tyre njerëzit, ngjarjet dhe idetë, sidomos në raport me prodhuesit dhe kontrolluesit e këtyre mesazheve.<br>3. Të vlerësojë: strukturën, përmbajtjen dhe qëllimin e mediave masive, si dhe ndikimin e tyre në shoqëri, kulturë, ekonomi dhe politikë.<br>4. Të marrë pjesë në diskutime brenda orës, duke shtruar pyetje relevante por pa e monopolizuar bisedën.<br>5. Të zhvillojë shkathtësi të mbledhjes të të dhënave e njohurive dhe përpunimit të tyre në formë të shkruar. |

| **Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithësej** |
| Ligjërata | 1,30 | 15 | 19,5 |
| Ushtrime | 1,30 | 15 | 19,5 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 0,30 | 2 | 1 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 5 | 2 | 10 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 10 | 20 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 4 | 5 | 20 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 2 | 5 | 10 |
| Projektet,prezentimet ,etj | 5 | 2 | 10 |
| **Totali** | | | **150:25=6** |
| | | | |
| **Metodologjia** | | | |

| | |
|---|---|
| **e mësimëdhëni es:** | Studentët janë të obliguar t'i lexojnë materialet përkatëse para orës. Mësimdhënia dhe mësimnxënia nuk do të shihen të ndara preras, sipas procedurave mekanike, por do të jenë vazhdimisht të ndërlidhura me njëra tjetrën, si marrje dhe dhënie e ndërsjellë, që i ofrojnë mundësi secilit student të marrë pjesë në këtë proces dhe të japë kontributin personal në prodhimin e vazhdueshëm të dijes. |
| | |
| **Metodat e vlerësimit:** | Testi 60 %<br>Ushtrimet 40 %<br>Gjithsej 100 % |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | Libri **Komunikimi Masiv dhe Edukim për Media**, autore Lindita Aliu Tahiri (libër elektronik: tetor 2017)<br>https://stereotipe.wordpress.com/ |
| **Literatura shtesë:** | 1. "*Komunikimi*" nga Christian Baylon dhe Xavier Mignot, Logos A, Shkup 2004.<br>2. "*McQuail's Mass Communication Theory*", Denis McQuail, Sage Publications,2005<br>3. " *Media: agjensët e komunikimeve*" nga Ibrahim Berisha, Pen Qendra e Kosovës, Prishtinë 2006.<br>4. "*Mediamorfoza* " nga Roger Fidler, Instituti Shqitpar i Medias, Tiranë 2001.<br>5. "*The Global Media*", Edward S. Herman & Robert W McChesney, Cassell, London, 1997<br>6. "Lexime në komunikim" nga Artan Fuga, Ora, 2005. |

| | |
|---|---|
| | 7. " The New Media Monopoly", nga Ben.H. Bagdikian<br>8. " The Problem of the Media: U.S. Communication Politics in the Twenty-First Century", nga Robert W.McChesney<br>9. Hardt, Hanno. *Myths for the Masses. Blackwell*: 2004<br>Extensions of Man. McGraw-Hill, 1964. 1-18. web.mit.edu/allanmc/www/mcluhan.medium message.pdf<br>Chomsky, Noam, and Edward Herman. "A Propaganda Model." Manufacturing Consent. Pantheon, 1988. chomsky.info/consent01/<br>Jenkins, Henry. "Buying into American Idol: How We Are Being Sold On Reality Television.<br>" Convergence Culture. NYU Press, 2006. 59-92. www.athabascau.ca/courses/cmns/medialit/modules/12/L03/documents/american_idol.pdf |

| **Plani i dizejnuar i mësimit:** | |
|---|---|
| **Java** | **Ligjerata që do të zhvillohet** |
| ***Java e parë:*** | **Njohje me lëndën** |
| ***Java e dytë:*** | **Kapitulli I, Pjesa e parë. Komunikimi, komunikimi masiv, gjuha**: Çka është komunikimi? Komunikimi dhe gjuha. Idioloekti. |
| ***Java e tretë*:** | Komunikimi, mendimi, kuptimi. Komunikimi ndërpersonal dhe retorika Çka është komunikimi |

| | |
|---|---|
| | masiv |
| ***Java e katërt:*** | Skema e komunikimit. Rindërtimi i kuptimit dhe maksimat e bisedës . Audienca masive dhe dimenzionet e saj |
| ***Java e pestë:*** | **Përsëritje e pjesës së parë. Kapitulli II. Komunikimi masiv dhe shoqëria:** Ndërmjetësim apo bindje? |
| ***Java e gjashtë***: | Koncepti dhe rëndësia e sferës publike |
| ***Java e shtatë:*** | Fushatat shoqërore. Segmentim apo integrim shoqëror. |
| ***Java e tetë:*** | Gazetaria me përgjegjësi shoqërore. |
| ***Java e nëntë:*** | **Diskutim për kapitujt e kaluar** |
| ***Java e dhjetë:*** | **Kapitulli III. Komunikimi masiv dhe kultura:** Kultura masive dhe kultura e popullarizuar. Shkolla e Frankfurtit dhe kritika e kulturës masive. |
| ***Java e njëmbëdhjete***: | Cilësia dhe komercializimi. Letërsia e popullarizuar. **Përsëritje e kapitullit të tretë.** |
| ***Java e dymbëdhjetë***: | **Përsëritje.Kapitulli IV. Komunikimi masiv dhe teknologjia:** Zhvillimi i komunikimit. Fillimet e gazetarisë, pushteti dhe sensacionalizmi. |
| ***Java e trembëdhjetë***: | Teknologjia dhe komunikimi njerëzor |
| ***Java e katërmbëdhjetë***: | Zhvillimi historik i medias masive: përmbledhje |
| ***Java e pesëmbëdhjetë***: | **Diskutim për kapitujt e kaluar** |

| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: |
| --- |
| Studentët nuk duhet të hyjnë në orë nëse vonohen ose nëse planifikojnë të dalin më herët nga mësimi.<br>Gjatë diskutimeve studentët duhet ta respektojnë njëri-tjetrin, të mos ndërhyjnë në fjalët e tjetrit, të tolerojnë mendime të ndryshme, të mos paragjykojnë dhe të mos ofendojnë, dhe të mos e shfrytëzojnë orën e mësimit si tribunë për promovim personal, duke e penguar kështu procesin e nxënies të tërë klasës. |